



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS
CENTAR ZA KINEMATOGRAFIJU KOSOVA
KOSOVA CINEMATOGRAPHY CENTER

Datë: 05.06.2012

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë: 05.06.2012, në përbërje prej: Arben Zharku - Kryesues, Burbuqe Berisha, Agron Vula, Ilir Kabashi dhe Arben Apolloni - anëtarë, në zbatim të nenit 29 paragrafi 2 pika c) të Ligjit për Kinematografinë nr. 2004/22, dhe nenit 5 paragrafi 2 pika f) të ndërlidhur me nenin 14 pika 2, të statutit të Qendrës Kinematografike të Kosovës në mënyrë unanime mori këtë:

VENDIM

Emërohen anëtarët e Jurisë vlerësuese për projektet filmike të arritura në konkurset e vitit 2012 për katër kategoritë e filmit.

Anëtarë të jurisë për vitin 2012 emërohen:

1. Ilire Vinca - Aktore /Profesoreshë në Fakultetin e Arteve
2. Jeta Xharra - Dramaturge/Gazetare
3. Dritan Huqi - Producent
4. Liridon Cahani - Regjisor
5. Anisa Ismajli - Aktore
6. Trimor Dhomi - Kompozitor/Profesor në Fakultetin e Arteve
7. Zymber Kelmendi - Skenarist/Profesor në Fakultetin e Arteve

Anëtarët e jurisë, gjatë vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve janë të obliguar të zbatojnë Ligjin për Kinematografinë dhe Statutin e Qendrës Kinematografike të Kosovës. Juria vlerësimet e veta në formë të shkruar ia paraqet QKK-së.

Anëtarët e jurisë në mbledhjen e parë, nga radhët e veta e zgjedhin Kryesuesin, i cili do të udhëheqë procedurat e vlerësimit të projekteve.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë kërkesë për rishqyrtim të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh. Ankesa i drejtohet Këshillit Drejtues, përmes Qendrës Kinematografike të Kosovës.

Kryesuesi:

z. Arben Zharku